



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDËTIT PUBLIK

BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

QERSHOR 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Te dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Qershor janë të dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Qershor 2018 zënë 40.2% të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidence 261.49/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehte të vitit mbart me vete frekuencën me të larte të episodeve diarreike dhe në muajin qershor vihet re një tendence në rritje të sëmundjeve diarreike. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozes jotifoide dhe Shigelozes për muajin Qershor 2018 në nivel kombëtar përkatësisht me incidente 1.5/10.000 banorë dhe 2.59/10.000 banorë. Vlen të përmendet prejka e moshave femnore përkatësisht < 1 vjeç dhe 1-4 vjeç. Duke ju referuar raportimeve të toksikoinfeksioneve alimentare gjate muajit maj 2018 në nivel kombëtar incidenca është 5.29/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Te gjitha rastet janë sporadike, nuk kanë patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe nuk kanë qene pjese e ndonjë shpërthimi. Incidenca e gastroenteriteve të paspecifikuara për muajin Qershor 2018 në nivel kombëtar është 253.59/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike në Qershor 2018 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste, Qershor 2018	Incidenca Qershor 2018 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmonelozë	28	1
Shigeloze (Disenteri bacilare)	45	1.61
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	148	5.29
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	7101	253.59
Semundje diarreike në total	7322	261.49

2. Semundjet e EPI

2.1.Fruthi

Gjate muajit Qershor 2018 ne kuadrin e vazhdimësisë se epidemisë se fruthit janë konfirmuar me IgM pozitiv 134 raste nga 224 raste qe janë dyshuar ne total. Rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Qershor 2018



Rastet i përkasin kryesisht moshës pediatrike (<1 vjeç) moshe qe sipas kalendarit te vaksinimit nuk e ka kryer dozën e pare te FRP. Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike te rasteve te dyshuara dhe te konfirmuara me fruth e mban Tirana, Kruja dhe Durrësi.

2.2.Tuberkulozi pulmonar

Gjate muajit Qershor 2018 janë raportuar 33 raste me Tuberkuloz pulmonar, ekstrapulmonar dhe miliar me ane te Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHIP-te dhe DSHP-te. Vihet re nga te dhënat e ardhura ne ISHP qe peshën me te madhe te rasteve e mban Tirana dhe Durrësi. Grupmosha me e prekur është 15-65+ vjeç. Nga 33 raste te suspektuara 25 janë te konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar.

3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.61/100.000 banore. Rastet për muajin Qershor 2018 janë raportuar nga rrethet Gjirokastrë, Dibër, Librazhd, Lushnjë, Pogradec, Sarandë. Gjate muajit qershor ne pasqyrën 14 sh është raportuar një rast i suspektuar me Leishmanie kutane nga rrethi i Matit i grupmoshës 1-4 vjeç, një rast i konfirmuar Leptospiroze i grupmoshës 45-49 vjeç nga rrethi i Durrësit dhe një rast i konfirmuar antraks nga Delvina i grupmoshës 50-54 vjeç.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Qershor 2018(Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Qershor 2018	Incidenca Qershor 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	1	0.04
Brucelozë	17	0.61
Leptospirozë	1	0.04
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	1	0.04

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te semundshmerise infektive gjate muajit qershor 2018 janë raportuar ne total 14 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.50/100.000 banore) nga te cilat 8 raste janë Hepatite virale te paspecifikuar dhe 6 raste me Hepatit viral akut B. Ne lidhje me HBV, 6 rastet i përkasin grupmoshave: 20-24 vjeç (1 rast), 30-39 vjeç (2 raste), 50-59 vjeç (3 raste). Shpërndarja e rasteve te konfirmuara me HBV: Shkodra dhe Tirana me dy raste secila, Elbasan dhe Kuçova me nga një rast.

5. Meningoencefalite

Gjate muajit Qershor 2018 kemi vetëm dy raste encefalite te paspecifikuara te suspektuara te grup-moshës 25-29 nga Tirana dhe Pogradeci.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë.**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI